



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:191986
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05783688

K.DH.Shk II.nr.930/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbarimore të “DLD Group” SH.P.K., me NUI: 810841636, me seli në rr. “Perandori Justinian” nr.25, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Hoti, avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në rr. “UÇK” nr. 2, në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1441/23 të datës 26.01.2024, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “DLD Group” SH.P.K me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1441/23 të datës 26.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1421 të datës 29.01.2024, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr.617/23 të dt. 24.08.2023 të Përmbaruesit Privat Irfan Kerçagu, dhe i njëjti Urdhër për përmbarim është përfunduar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës, zbatimit të gabuar apo jo të plotë të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1441/23 të datës 26.01.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “DLD Group” SH.P.K., me datën 24.08.2023 ka paraqitur propozimin për përmbaremore mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. Nr.2022/0019 të datës 29.08.2022, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga fatura e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,000.00 Euro, me kamatë prej 8% sipas LMD-së që nga data e paraqitjes së propozimit për përmbaremore e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, nën kërcënim të përmbaremore të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, për shkak të cenimit qenësor të rregullave të procedurës përmbaremore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka theksuar se urdhri për përmbaremore i lëshuar nga Përmbareuesi Privat është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se i njëjti nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe se provat të cilat i janë bashkangjitur propozimit nuk janë dokumente të besueshme sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se kreditori ka dështuar të bashkangjitur provat e nevojshme mbi të cilat e bazon propozimin për përmbaremore, dhe me këtë rast ka bashkangjitur vetëm faturën kopje dhe pa konstatim, e cila nuk plotëson kushtet esenciale për faturë të paraparë me nenin 22 lidhur me nenin 29 të LPP-së, dhe si i tillë nuk mund të jetë objekt përmbaremore. I ka propozuar

gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat. Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se prapësimi nuk është në pajtueshmëri me nenin 71 të LPP-së dhe paragrafet e kësaj dispozite ligjore, duke shtuar se fatura me nr.2022/0019 e datës 29.08.2022, është ekzekutive. Tutje ka theksuar se kjo faturë meqenëse është në rregull, është e pranuar dhe e nënshkruar, e njëjta duhet ekzekutuar nën detyrimin e përmbarimit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, ndërsa të lejojë urdhrin përmbarimor, si dhe të detyrohet debitori t'i paguajë shpenzimet për avokatin sipas TOAK-së, dhe atë për propozimin për përmbarim shumë prej 104 Euro, përgjigjen në prapësim shumë prej 104 Euro, si dhe taksat dhe shpenzimet tjera kontestimore dhe përmbarimore. Gjithashtu, kreditori ka kërkuar nga gjykata që në rast se debitori parashtron ankesë ndaj vendimit të kësaj gjykate, të njejtin ta obligojë ta paguajë garancionin bankar sipas nenit 78 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata ka vlerësuar se në rasti konkret konkret Fatura Nr.2022/0019 të datës 29.08.2022 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar shkalla e parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet, përkatësisht fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk

mund të vërtetohet që fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi që e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit – Komuna e Prishtinës nuk mban vulën e pranimit - protokollimit, si dhe nuk është nënshkruar nga ana e debitorit, nga rezulton se si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbnim.

Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së parë gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përmbnim ia ka bashkangjitur faturën Nr.2022/0019 të datës 29.08.2022 e cila nuk është nënshkruar as pranuar nga debitori, në rastin konkret fatura nuk paraqet dokument të besueshëm pasi që nuk janë plotësuar kushtet nga neni 27 i LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbnim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbnimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbnim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbnjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbnimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se fatura si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbnimi nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument

i besueshëm për përmbardim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbardim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.930/24, me datë 05.06.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti